



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 46

Datë: 29. 10. 2020. Ora: 11:00.

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burmi Ahmetaj, kryeshef.

ZRPC: Ylli Buleshkaj, drejtor.

Përkthyese: Argjina Misini.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 41/2020 i KQZ

2. Shqyrtimi i vendimit të PZAP-së lidhur me anulimin e vendimit të KQZ-së nr.933-2020 të datës 21.10.2020:

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi raportit të punës të Sekretariatit të KQZ-së periudha: janar-shtator 2020:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë për ndryshim në planin e punës së KQZ-së për vitin 2020 për shkak të organizimit të procesit të jashtëzakonshëm zgjedhor në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut,

2. Këshilli për Informim Publik:

- **Aktivitetet e Këshillit për Informim Publik**

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 46-të të KQZ-së. A ka dikush vërejtje, a dëshiron ndokush të flas ?

Sami Kurteshi: Propozoj që pika 3, të nxirret s'i pikë e fillimit, të diskutohet në fillim...!

Arianit Elshani: Dua ta parashtroj një çështje që ka të bëjë me qytetarët, prandaj ngase jemi në fillim të organizimit të procesit të zgjedhjeve në Podujevë dhe Në Mitrovicë të veriut dhe ka të bëj me një pikë që është rekomanduar edhe nga z. Kurteshi në mbledhjen e kaluar; Duke marrë për bazë rritjen e numrit të të inferktuarve me kovid – 19, duhet ta trajtojmë ndryshimin e datën për personat e ngujuar në shtëpi... Duke e ditur se 6 nëntori është larg nga dita e votimit 29 nëntor, propozoj që të gjithë të ngujuarit tu mundësohet deri më 26 nëntor përmes ekipeve mobile. Pra është një datë më afër, por që ne duhet t'i respektojnë masat antikovid dhe për këtë, është e duhur që të pyjet edhe IKSHP nëse, mundet që këta te ngujuar të votojnë përmes ekipeve mobile... Pra, ta trajtojmë s'i pikë në të ndryshme...

Valdete Daka: Ndryshimin e datave, së pari duhet të trajtohet në KOZ, që të mos ketë ndonjë interferim në ndonjë afat tjetër, e pastaj mund të caktojmë datë...

Alim Rama: S'i kryesues, ne presim raportin e Sekretariatit. Prandaj, njëherë të shihen të gjitha mundësítë teknike, e pastaj...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.41/2020. (Ri kthehet në miratim, me plotësim të vërejtjeve të anëtarit A. R.)

2. Shqyrtimi i vendimit të PZAP-së lidhur me anulimin e vendimit të KQZ-së nr.933-2020 të datës 21.10.2020:

Valdete Daka: Nga PZAP, vendimi ynë për mos regjistrim të partisë turke është anuluar, dhe është rikthyer përsëri në KQZ. Nuk janë konsideruar arsyet e bollshme, dhe kërkohet nga ne që edhe njëherë ta shqyrtojmë... E hedh në votim, sepse vendimi është i qartë, ne diskutimet i kemi përfunduar...

Rekomandimin e zyrës e kemi pas, dhe se ka qenë rekomandimi të regjistrohet... Ndërsa, çështjet tjera mund të ngritën në prokurori nga ata që kanë dyshime

Sami Kurteshi: Me vendimin e vetë, PZAP e ka vërtetuar me vendimin e vetë një absurd të KQZ! S'i institucion, KQZ ka marrë një vendim që është thelbi i demokracisë mos me e votuar një parti politike

që i plotëson të gjitha kushtet ligjore. Kjo, është një shuplakë e madhe e PZAP-së për KQZ-në! Po të shihendokumentet e aplikimit, shihet se KQZ nuk ka pasur të drejtë...

Rifat Krasniq: Kam problem me gjuhë, ndoshta s'kam mundur me shpjeguar mirë. S'po d'i pse Samia me e krye punën e avokatit... Personi që e ka formue subjektin turk, vetë nuk është komunitet turk, nëna e këtij personi ka qenë kandidate e subjektit shqiptarë "Ora", dhe ky person është në gjyq se ka vjedhë miliona dollarë...

570 nënshkrimet, 99% asnjëri nuk përfaqëson komunistin turk...! Kam ankesa edhe për drejtorin e ZRPP-së. Edhe njëherë, duhet me i kontrolluar dokumentet... Apeloj mos me e votuar këtu këtë parti...!

Sami Kurteshi: Nëse ju e doni monopolin politik në komunitetin turk, bëjeni ate... ! Por qytetarët që kanë nënshkuar dokumentet e këtij subjekti janë të republikës së Kosovës, secili qytetar që posedon dokumente të këtij vendi ka të drejtë me e nënshkrua një dokument që është publik. Ju dhe as ne, nuk kemi të drejtë me e kërkua verifikimin e nënshkrimeve sepse, këtë do të duhej ta bënte prokuroria... Bëni kërkesë në prokurori, sepse ne nuk kemi të drejtë me e vërtetuar këtë...

Valdete Daka: Nuk ka kuptim me e zgjatë më shumë debatin! Ne, e kemi një vendim të PZAP-së dhe, unë e hedh edhe njëherë në votim rekomandimin e ZRPP-së për ta votuar subjektin që ka aplikuar. Ne, e kemi shumë të qartë se a duhet apo nuk duhet ta votojmë. Vendimet e PZAP-së janë të obligueshme, dhe madje fare nuk duhet as të diskutohen...! Prandaj, kush është për që subjekti me emrin "Yenilikçi Türk Hareket Partisi" (YTHP), e cila në regjistrin e partive do ta merrete numrin 46.

Anëtarët e KQZ-së, me 1 votë kundër (Rifat Krasniq) dhe me 9 vota për, miratuan rekomandimin e ZRPP-së për regjistrimin e këtij subjekti të ri politik.

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrimi dhe miratimi raportit të punës të Sekretariatit të KQZ-së periudha: janar-shtator 2020:

Alim Rama: Këshilli e ka marrë raportin e Sekretariatit, dhe e kemi trajtuar! Është një raport detal, por jo edhe për aktivitetet e brendshme. Raporti, ka disa informata në mënyrë të përgjithshme, por jo të detajuara: për shembull aktiviteti nr.1, 2 etj. Z. Rama, shpjegoji para anëtarëve të KQZ-së se, ku qysh, dhe cilat janë vërejtjet e tij në relacion me aktivitetet e Sekretariatit. Raporti, ka tendencia të paraqesë progres në punët që janë duke u kryer në 65.2%, dhe ato që janë kryer, 34.8 %. Realizimet janë të gjitha aktivitete të rregullta, dhe disa analiza...Por, puna kryesore është Sekretariati të punojë në procesin zgjedhorë, fatkeqësisht disa punë nuk janë kryer dhe nuk por kryhen sidomos, ato që kanë të bëjnë me votuesin nga mërgata...

Eshref Vishi: I kemi dy pikë, dhe për mendimin tim këto dy pikë janë të përbashkëta...Së pari, plani i punës nuk është vetëm i Sekretariatit por ju ka nënshtruar edhe vendimit tonë në KQZ...Po e nisi nga plani: raporti, rrjedh nga plani. Plani është dokument esencial. Duke e pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e planit të punës, përgjegjësia e hartimit, menaxhimit dhe e zbatimit të planit me të drejtë bie mbi

menaxherët e Sekretariatit. Atyre, u lihet hapësirë pjesëmarrja n'këtë proces, ashtu s'i edhe një nivel i caktuar përgjegjësie... Hartimi i planit, evidentimi i objektivave, s'i dhe përcaktimi i aktiviteteve në përmbushjen e tyre, fillon nga ata... Plani duhet të jetë kompatibil me planin strategjik që nuk e kemi ende, me kapacitetet kadrovike e profesionale buxhetore që ka institucioni, përndryshe është i destinuar të dështoj në detyrat e tij...!

Më tutje, z. Vishi, zbërtheu të metat që ka plani. Janë planifikuar 69 aktivitete, dhe sot kërkohet që të hiqen një pjesë e madhe e tyre. Ai, tha se Sekretariati ka divergjencia dhe mos unitetin e Sekretariatit që e ka penguar realizimin e planit... Rishikim i planit bëhet në mes të vitit nga institucionet dhe kërkesa për rishikim dhe plotësim të planit dy muaj para se me u mbyllë viti, përmua është jo serioze dhe jo profesionale... Kjo përmua, përmë tepër është tendencë përmë e mbuluar pamundësinë e realizimit të tij...

Asgjë, se ka penguar Sekretariatin që të bëjë rishikimin në mes të vitit... Raporti që është dorëzuar, ka përbajtje identike me planin e punës... sikur po fillon tani të realizohet, tha ndërt të tjera z. Vishi. Ai, shtroi pyetje lidhur me aktivitetet e planit të shtruara në raportit, dhe bëri kritikë gjerë rrëth tyre...

Ibrahim Selmanaj: E vërteta është se edhe Sekretariati e ka pranuar se ka pasur neglizhencë! Rritja e përgjegjësisë, nxjerrë efikasitet më të madh. Kemi pasur zgjedhje të brendshme dhe rrëthana tjera, por nuk mund t'i arsyetojmë papërgjegjshmëritë e Sekretariatit... Afatet ligjore, detyrimisht është dashur me i respektuar, prandaj mendoj që duhet të fokusohemi në aktivitetet zhvillimore në vitin që vjen meqë, kemi zgjedhje të rregullta...

Sami Kurteshi: A është raporti përmë votim...? Po, mendoj që duhet dhënë kohë Sekretariatit që ta shikoj raportin me shumë kujdes. Neve na duhet me e ditë saktësish ku jemi, prandaj le të na sillet një raport që na tregon se ku jemi, pra të merren edhe këto vërejtje... Pra, ky është propozimi im...

Arianit Elshani: E kemi trajtuar shumë seriozisht, kemi diskutuar gjerë e gjatë. Kemi qenë kritik mbi punën e Sekretariatit, mirëpo i dimë edhe arsyetimet përmë ndryshime që janë dhënë në qershor, s'i dhe rrëthanat e miratimit, dhe se është gjykuar s'i lehtë i zbatueshëm ky plan, por sot jemi dëshmitarë të asaj se nuk është realizuar në një masë të madhe...

I mbetet Sekretariatit që të realizoj, dhe kjo ishte edhe kërkesa e KOZ-it që aktivitetet që janë në plan të punës të kryhet në këtë vit kalendarik, dhe të mos lihen përmë vitin tjetër... Por, kemi pasur mjaft rrëthana që i kanë prolonguar aktivitetet, por kërkesa jonë është që këto aktivitete të kryhen në këtë vit kalendarik...

Sami Hamiti: Dy elemente dua t'i plotësoj: raporti është i strukturuar mirë – i analizuar mirë, pra paraqet shumë saktë aktivitetet që janë kryer dhe, ato që nuk janë shkruar. Mendoj që në raport s'ka çka të rishikohet më tutje, vetëm të kryhen – realizohen ato...

Čemailj Kurtiši: Nuk dua të përsëritëm me koleget, por pandemia neve na ka stresuar. Disa aktivitete nuk kanë mundur të realizohen, disa është dashur të shtyhen. Shënimet thonë se 47 aktivitete janë në proces, dhe qoftë edhe përafërsisht këtë plan duhet ta përfundojmë, mbase shumicën e tij...

Alim Rama: Raporti s'i i këtillë, paraqet gjendjen faktike. Përmë këtë, ne rekomoandojmë që të aprovohet. Por, pajtohem plotësish me z. Vishi. Plani i punës, duhet me pas aktivitete zhvillimore. Pra, krejt fokusi duhet me qenë të këto punët zhvillimore, përndryshe Sekretariati këtë punë ka, është roli mbikëqyrës dhe përgjegjës...!

Valdete Daka: Pajtohem me gjithë këto që u thanë lidhur me raportin e punës. Është e vërtetë se Sekretariati është i varur nga KQZ, në aspektin negativ por, kjo është pengesë sepse në punën e tyre më shumë mendojnë se cka thotë KQZ, sepse për punën që bëjnë... Dhe jam i bindur që as 30% prej tyre nuk do të përfundohen sepse, jo zgjedhjet...jo pandemia...! Por, unë kam një lutje: mos të kërkohen apo planifikohen projekte që nuk munden me u realizua...

Nëse nuk kemi gjë tjetër, e hedh në votim...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin e planit janar - shtator.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë për ndryshim në planin e punës së KQZ-së për vitin 2020 për shkak të organizimit të procesit të jashtëzakonshëm zgjedhor në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut:

Alim Rama: Sekretariati, ka kërkuar që 18 aktivitete të shtyhen për vitin e ardhshëm! E keni para jush raportin. Pra, këto aktivitete, u pajtuam apo jo, Sekretariati nuk mund t'i realizoj... Unë, kërkoi që vendimet e KQZ-së, s'i dhe raportet e punës të bëhen publike. Ne, duhet të jemi transparent...

Valdete Daka: Vendimet tonë, unë e di që duhet të publikohen...! Një gjë nuk e para të qartë, miratimi i planit të trajnimeve pse është shtyrë...

Burim Ahmetaj: Në bazë të kohës që na ka mbet dhe zgjedhjeve, na ka ardhur kërkesa nga departamenti që ky aktivitet për shkak të kohës dhe ngarkesave tjera, nuk do të mund të realizohet...Fjala është faktikisht, për trajnimin e vëzhguesve të KKZ-ve që e vëzhgojnë procesin zgjedhorë.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan ndryshimet e planit.

4. Këshilli për Informim Publik:

Aktivitetet e Këshillit për Informim Publik:

Arianit Elshani: Para kësaj, dua të potencoj faktin që është rekomanduar edhe në këshill, ne duhet ta miratojmë një tekst që do ta tregonte qartë mesazhin për personat e ngujuar në shtëpi dhe për personat që infektohen me kovid – 19, deri në datën që e përcaktion KQZ... Ndërr të tjera kemi, kemi miratuar edhe tekstet për informim për ndërrimin e qendrës së votimit për të gjithë ata persona që në kuadër të listës votuese janë përcaktuar në një qendër votimi larg vendbanimit të tyre, po ashtu tekstet për periudhën e aplikimit për votuesit për regjistrim përmes postës, pra veçanërisht përmërgatën...

Janë miratuar edhe njoftimet që duhet të transmetohen në media, në rrjetet sociale, në RTK, pastaj të informohen subjektet politike, si dhe diaspora të njoftohet përmes ministrisë së jashtme...

Sami Kurteshi: Numri i personave që po infektohen, është në shtim e sipër, meqë po mbajmë zgjedhje vetëm në dy komuna ku numri i vitusve nuk është i madh, KQZ të marrë kontakte me IPSHK-në me

institucionet e tjera që ti identifikoj personat me kovid që atyre tu mundësohet të votojnë...Mendoj se, deri në momentet kur mbyllt procesi, atyre duhet kërkuar rrugë që tu mundësohet votimi... Nuk ka rëndësi sa persona janë ! Qoftë edhe vetëm 1 person, edhe deri më 28 nëntor, atyre tu mundësohet...

Valdete Daka: Ne, nuk mundemi që në ditën e fundit t'i ndryshojmë listat...

Në këtë pikë, diskutuan më tej edhe: Arianit Elshani, Artan Asllani dhe Valdete Daka. Në fund, znj. Daka tha se, sekretariati do të kontaktoj me IKSHP-në dhe, të shohim se s'i duhet t'i trajtojmë këta persona...

5. Të ndryshme.